

Buletini i aktiviteteve

“Kujdesu për veten tënde, kujdesu për paratë e tua”

Java Globale e Parasë është një fushatë vjetore e ndërgjegjësimit të popullatës për edukim dhe arsimim financiar. Edhe këtë vit AMS-ja merr pjesë në fushatë me aktivitetet e bashkangjitura.



AGJENCIA E
MBIKËQYRJES
SË SIGURIMEVE



Java Globale e Parasë;



Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS) realizon aktivitete të vazhdueshme për rritjen e ndërgjegjësimit civil për rolin e sigurimeve dhe mbikëqyrjen e sigurimeve dhe në mënyrë të integruar vepron në fushën e edukimit financiar, përfshirjes financiare dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të të siguruarve apo policëmbajtësve.

Në materialet edukative të AMS-së janë hartuar disa aspekte: roli i AMS-së dhe funksioni i saj, institucionet kryesore financiare, konceptet në fushën e sigurimeve dhe mbikëqyrjes, kuptimi i sigurimeve dhe përfitimet e tyre, si dhe mbrojtja e policëmbajtësve.

AMS-ja në faqen e saj të internetit dhe në portalin edukativ ka publikuar një sërë materialesh edukative për grupe të moshave të ndryshme.



Po afron Javë Globale e Parasë e cila do të mbahet nga data 25 deri në 31 mars. Tema e fushatës së sivjetshme është Take care of yourself, take care of your (Kujdesu për veten tënde, kujdesu për paratë e tua).

Tradicionalisht, si në vitet e mëparshme, në këtë fushatë mbahen aktivitete të shumta në fushën e financave në mënyrë që të rritet edukimi financiar, përfshirja financiare dhe mbrojtja e konsumatorit.

Në kuadrin e kompetencave të saj ligjore për të inkurajuar zhvillimin e tregut të sigurimeve dhe për të zhvilluar ndërgjegjësimin e publikut për rolin e sigurimeve dhe rolin e mbikëqyrjes së sigurimeve, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS) edhe këtë vit do të marrë pjesë në Javën Globale të Parasë, përmes aktiviteteve të mëposhtme: leksione edukative online, paraqitje në TV, promovim të përmbajtjeve të dobishme dhe dhënien e këshillave për siguruesit ose policëmbajtësit përmes portalit edukativ me fokus në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre, ndarjen e informacionit të dobishëm dhe në kohë përmes faqes në internet dhe rrjeteve sociale, promovimin e praktikave të mira në fushën e edukimit financiar dhe përfshirjes financiare, rritjen e ndërgjegjësimin të shoqërive të sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve për të rritur aktivitetet që synojnë edukimin dhe informimin e klientëve në mënyrë më të detajuar në lidhje me të gjitha aspektet që lidhen me produktet dhe shërbimet e sigurimeve.

Më tepër informacione për Javën Globale të Parasë do të gjeni në <https://www.globalmoneyweek.org/>

10.03



“Më pak rrezik, më shumë argëtim”, lojë zbavitëse në grup - si të shmangni rreziqet dhe si t'i menaxhoni ato. Kjo lojë adreson risqet dhe rreziqet e ndryshme që mund të hasin pjesëmarrësit gjatë gjithë jetës së tyre.

Të rinjtë duhet të nxiten që të provojnë gjëra të reja, por në të njëjtën kohë të njohin rreziqet e mundshme, të mësojnë se si t'i menaxhojnë dhe në këtë mënyrë t'i tejkalojnë ato.

ANKETË Ë KËNAQSHMËRISË SË PËRDORUESVE



Për të përmirësuar përvojën e përdoruesve, Ju lutemi të vlerësoni funksionalitetin e faqes së internetit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS).

Për plotësimin e sondazhit nuk do t'ju nevojiten më shumë se 5 minuta, ndërsa të dhënat janë plotësisht anonime dhe për përdorim intern të AMS-së!

 <https://bit.ly/3bgUm8o>

15.03



AGJENCIA E
MBIKËQYRJES
SË SIGURIMEVE

**DITA BOTËRORE PËR TË
DREJTËN E KONSUMATORËVE**

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Organizata e Konsumatorëve të Maqedonisë do të forcojnë bashkëpunimin e ndërsjellë për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtjen e konsumatorëve-policmbajtësve dhe përdoruesve të shërbimeve dhe produkteve të sigurimit, si dhe përafrimin dhe sigurimin e aksesit në produktet dhe shërbimet e sigurimeve përmes:

- Promovimit të parimeve të marrëdhënieve korrekte ndaj konsumatorëve,
- Informacionit në kohë dhe të besueshëm,
- Ofertës më të madhe të produkteve dhe shërbimeve dhe përgjegjësi më të madhe të shoqërive të sigurimeve dhe ndërmjetësve në sigurime,
- Rritjes së ndërgjegjësimit publik të popullatës për të drejtat dhe detyrimet në lidhje me produktin e blerë të sigurimeve,
- Përmirësimit të informimit dhe edukimit të vazhdueshëm të konsumatorëve për zgjedhjen e duhur të produkteve dhe shërbimeve të sigurimeve,
- Forcimit të proceseve dhe procedurave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të të siguruarit dhe rritjen e përgjegjësisë shoqërore të shoqërive të sigurimeve dhe ndërmjetësve në sigurime.

17.03



- Çfarë është sigurimi?
- Përse është i nevojshëm?
- Ku mund të siguroheni?

Testoni njohuritë tuaja lidhur me sigurimin
përmes kuizit vijues:
<https://aso.mk/quiz/final/>

17.03



Në prag të "Javës Globale të Parasë", me qëllim të ndërgjegjësimit publik të qytetarëve për përfitimet e sigurimeve, aktivitetet me të cilat Agjencia e Mbikëqyrjes të Sigurimeve – AMS e përkrah fushatën globale, këtë mëngjes në TVM 1 u prezantuan nga Ratka Celakovski.

18.03



Tekste edukative!

#KLIK 

<https://edukacija.aso.mk/sq/tekste-edukative/>

19.03



“Më pak rrezik, më shumë argëtim”, lojë zbavitësve në grup - si të shmangni rreziqet dhe si t'i menaxhoni ato.

Kjo lojë adreson risqet dhe rreziqet e ndryshme që mund të hasin pjesëmarrësit gjatë gjithë jetës së tyre.

Të rinjtë duhet të nxiten që të provojnë gjëra të reja, por në të njëjtën kohë të njohin rreziqet e mundshme, të mësojnë se si t'i menaxhojnë dhe në këtë mënyrë t'i tejkalojnë ato.

22-28 MARS 2021

**KUJDESU PËR
VETEN TËNDE,
KUJDESU PËR
PARATË E TUA**

www.globalmoneyweek.org
#GlobalMoneyWeek2021

 AGJENCIA E
MBIKËQYRJES
SË SIGURIMEVE

“Java Globale e Parasë” - Fushata vjetore për rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës për edukimin dhe arsimimin financiar me fokus të veçantë tek të rinjtë. Organizatori është Rrjeti Ndërkombëtar për Edukimin Financiar në Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (INFE_OECD).

Vendi ynë është anëtar i INFE përmes Trupit Koordinues Kombëtar të Rregullatorëve Financiarë në fushën e edukimit financiar dhe përfshirjes financiare. Rrjeti Ndërkombëtar i Edukimit Financiar (INFE) mbështet politikëbërësit dhe rregullatorët financiarë në hartimin dhe zbatimin e strategjive kombëtare të arsimit financiar, ndërsa propozon metoda inovative për përmirësimin e njohurive financiare të popullatës së vendeve partnere.

Tema e fushatës së sivjetshme është “Kujdesu për veten tënde, kujdesu për paratë e tua”, kontroll mbi financat personale sot dhe në të ardhmen, sepse mënyra se si përdoren paratë sot do të ketë ndikim në jetën në të ardhmen. Ne duhet të jemi të përgatitur financiarisht për të përballuar situata dhe rrethana të paparashikueshme të mundshme në jetën tonë.

22.03



Broshura e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve -
AMS dhe kompetencat e saj.

<https://aso.mk/sq/ams-broshure/>

23.03



Edukimi i fëmijëve dhe të rinjve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre sociale dhe ekonomike është thelbësore për krijimin e brezave të aftë të ardhshëm, të cilët mund të marrin vendime të mençura për të ardhmen e tyre.

#GlobalMoneyWeek

24.03



Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, përmes bashkëpunimit më të ngushtë me Asociacionin e Bankave të Maqedonisë, mbështet kuizin evropian të parasë. Kuizi është një projekt i Federatës Evropiane të Bankave dhe fokusohet në edukimin financiar të nxënësve nga 13 deri në 15 vjeç.

Klik – <https://mba.mk/w/mk/evropski-kviz-na-pari-2021/>



AGJENCIA E
MBIKËQYRJES
SË SIGURIMEVE


**KUIZIN EVROPIAN
TË PARASË**



AGJENCIA E
MBIKËQYRJES
SË SIGURIMEVE

www.aso.mk | www.edukacija.aso.mk

25.03



Kjo broshurë i shpjegon fillimet e sigurimeve, si funksionojnë ato dhe si fitojnë shoqëritë e sigurimeve.

<https://edukacija.aso.mk/2020/01/08/%d0%ba%d0%b0%d0%ba%d0%be-%d1%84%d1%83%d0%bd%d0%ba%d1%86%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b8%d1%80%d0%b0-%d0%be%d1%81%d0%b8%d0%b3%d1%83%d1%80%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5%d1%82%d0%be/>



Sigurimi blihet për tu mbrojtur nga ngjarjet aksidentale që mund t'ju ndodhin juve apo të afërmeve tuaj dhe në këtë mënyrë ju nuk do të gjendeni në vështirësi serioze financiare.

- Lexoni më shumë në:

<https://edukacija.aso.mk/2019/07/11/%d0%ba%d0%bd%d0%b8%d0%b3%d0%b0-%d0%b7%d0%b0-%d0%bf%d0%b0%d0%bc%d0%b5%d1%82%d0%bd%d0%be-%d1%83%d0%bf%d1%80%d0%b0%d0%b2%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d1%81%d0%be-%d0%bf%d0%b0%d1%80%d0%b8%d1%82%d0%b5/>